

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Themelore Gjilan - Departamenti i Përgjithshëm, përmes gjyqtarit të vetëm gjykues Islam Thaçi, me sekretaren juridike Rafete Sylja, në lëndën penale kundër të pandehurit E. A., për shkak të veprës penale, rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 paragrafi 8 lidhur me paragrafin 6 dhe 1 të KPRK-së, i përfaqësuar nga mbrojtësi, av. A. Xh., sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, PP.II.nr. 226/16 të datës 12.04.2016, të cilën e përfaqësonte Prokurori i Shtetit, Ismet Ukshini, pas mbajtjes së seancës dëgjimore lidhur me shqyrtimin e marrëveshjes për pranimin e fajësisë, më 20.09.2017, shpalli publikisht, ndërsa më 06.10.2017 hartoi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri **E. A.**, nga babai I. dhe nëna H., e lindur B., i lindur më datë ..., në Gj., ku edhe jeton, ka të kryer ..., i punësuar ..., i martuar, baba i ... fëmijëve, i gjendjes së ... ekonomike, shqiptar, shtetas i Repbulikës së Kosovës, i pa dënuar më parë si dhe nuk udhëhiqet procedurë tjetër penale ndaj tij.

ËSHTË FAJTOR

Sepse më datë2016, rreth orës ... minuta, në Gj. në rrugën "...", përball "...", duke e drejtuar në drejtim të qendrës automjetin e udhëtarëve të markës "... me ngjyrë ... dhe targa të regjistrimit ... , ka shkelë paragrafin 54.1 të nenit 54 të LSKRR dhe me këtë ka rrezikuar jetën e njerëzve dhe pasurinë, në atë mënyrë që nuk iu është përmbajtur dispozitave të përmendura që kanë të bëjnë me obligimin e shoferit që ai duhet ta ngasë mejtin, në kushtet ekzistuese të komunikacionit, posaqërisht duke pasur parasysh pamjen, kushtet dhe dukshmërinë e rrugës, kushtet dhe ngarkesën e mjetit, kushtet atmosferike dhe dendësinë e komunikacionit, në mënyrë që mjetin e vet ta ndalë para çdo pengese, lehtë ka menduar se edhe përkundër këtyre lëshimeve nuk do të shkaktojë pasojë të ndaluar, ashtu që me të arritur në vendin e përmendur me kohë nuk ka mundur ta frenojë dhe ndalë automjetin e përmendur, dhe për pasojë me pjesën e djathë të këtij automjeti ka goditur fëmiun, tani të dëmtuarin A. I. nga Gj., dhe me këtë rast të njejtin e ka përplasur në trotuar, me ç'rast të njejtin i ka shkaktuar lëndime të rënda trupore në formë të ndrydhjeve të indeve të buta të kokës me të enjtur dhe gjakmbledhje, thyerje të kockës temporale të kafkës në anën e djathë.

Me çka ka kryer veprën penale, **rrezikimi I trafikut publik nga neni 378 paragrafi 8 lidhur me paragrafin 6 dhe 1 të KPRK-së.**

Andaj gjykata në bazë të dispozitës së sipërtheksuar ligjore si dhe neneve: 4,7,41,49, 50, 51, 52 , 73, 74, 75,dhe 76 të KPRK-së si dhe nenit 233 dhe 365 të KPPK-së, të pandehurit, i shqipton:

Dënim me kusht

Ashtu që të pandehurit, **E. A.**, i shqipton dënimin me burgim në kohëzgjatje prej **145 (njëqind e katërdhjetë e pesë) ditëve**, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri brenda afatit prej **1 (një) viti e 6 (gjashtë) muajve**, nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryen veprë tjetër penale, në të kundërtën dënimi me kusht ka për t'iu revokuar.

I pandehuri obligohet që në emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej **20 (njëzetë) €**, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjilan, pranë kësaj gjykate ka paraqitur aktakuzën PP.II.nr. 226/16 të datës 12.04.2016, kundër të pandehurit, E. A., për shkak të veprës penale, rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 paragrafi 8 lidhur me paragrafin 6 dhe 1 të KPRK-së.

Prokuroria Themelore – Departamenti i Përgjithshëm në Gjilan, më datë 13.04.2016, në këtë gjykatë ka paraqitur marrëveshjen për pranim të fajësisë, të nënshkruar nga Prokurori i Shtetit, Ismet Ukshini, i pandehuri E. A. dhe mbrojtësi i tij, av. Sh. Sh..

Gjykata ka mbajtur seancën dëgjimore, në të cilën kanë prezentuar Prokurori i shtetit, Ismet Ukshini, i pandehuri, E. A., me mbrojtësin e tij sipas autorizimit zëvendësues, av. A. Xh., si dhe e nëna e të dëmtuarit A. I., Y. I..

Prokurori i shtetit deklaroi se, mbetet në tërsi pranë marrëveshjes për pranim të fajësisë, të datës 12.04.2016, të arritur ndërmjet prokurorisë dhe të pandehurit në fjalë me mbrojtësin e tij. Gjithashtu, shtoi se janë plotësuar kushtet ligjore në pajtim me nenin 233 të KPPRK-së, andaj kemi nënshkruar këtë marrëveshje me të pandehurin E. A. për shkak të veprës penale, rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 paragrafi 8 lidhur me paragrafin 6 dhe 1 të KPRK-së, me ç'rast, i njëjti është pajtuar që të pranoj fajësinë për të gjitha pikat e aktakuzës, edhe atë gjithnjë duke u konsultuar me mbrojtësin e tij.

Mbrojtësi i të pandehurit me autorizim zëvendësues, av. A. Xh. deklaroi se, ashtu siç theksoi edhe Prokurori i shtetit më datë 17.08.2017, pranë Prokurorisë Themelore në Gjilan, është arritur marrëveshja për pranim të fajësisë, në lidhje me veprën penale, rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 paragrafi 8 lidhur me paragrafin 6 dhe 1 të KPRK-së, dhe atë, pas konsultimeve të mjaftueshme me të mbrojturin tim, E. A., marrëveshja si e tillë është nënshkruar.

I pandehuri E. A., deklaroi se, e mbështet në tërësi deklaratën e mbrojtësit të tij.

Nëna e të dëmtuarit A. I. – Y. I., deklaroi se nuk e kundërshton këtë marrëveshje mbi pranimin e fajësisë.

Pas dëgjimit të palëve, gjykata në mbështetje të nenit 233 paragrafi 21 të KPPK-së, konstatoi se janë plotësuar kushtet e parapara me ligj, andaj mori aktvendim me të cilin e pranoi marrëveshjen për pranim të fajësisë, të lidhur mes

PTH-së – DP, dhe të pandehurit, E. A., me mbrojtësin e tij, av.Sh. Sh., për veprën penale, sipas dispozitivit të aktakuzës PP.II.nr. 226/16 e datës 12.04.2016.

Gjyqtari i vetëm gjykues, pas dëgjimit të palëve dhe në bazë të nenit 233 paragrafi 21, fjalia e dytë, të KPRK-së, vendosi që data e sotme të jetë data kur palët t'i japin deklaratat e tyre në lidhje me dënimin.

Prokurori I shtetit, Ismet Ukshini, deklaroi: i propozoj Gjykatës që marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë të dorëzuar në gjykatë, ta aprovojë si të tillë, duke pasur parasysh edhe marrëveshjen lidhur me caktimin e dënimit.

Nëna e të dëmtuarit - të miturit A. I. – Y. I. deklaroi: nuk i bashkangjitem ndjekjes penale dhe nuk paraqes kërkesë pasurore-juridike.

Mbrojtësi i të pandehurit sipas autorizimit zëvendësues, av. A. Xh., deklaroi: mbetem në tërësi pranë propozimit të lartë cekur, dhe kërkojë nga Gjykata që të pandehurit t'ia shqiptojë dënimin e rekomanduar në marrëveshje, duke konsideruar se një dënim i tillë është i mjaftueshëm për arritjen e qëllimit të dënimit.

I pandehuri E. A., deklaroi: e mbështes në tërësi fjalën e mbrojtësit tim, jam penduar për rastin që ka ndodhur, i kërkoj falje të dëmtuarit dhe se aksidenti ka ndodhur nga pakujdesia, i premtoj gjykatës që në të ardhmen nuk do të kryejë vepra penale.

Pas pranimit të marrëveshjes për pranimin e fajësisë për veprën penale të përshkruar si në dispozitiv me numër dhe datë të shënuar si më lartë, si dhe dëgjimit të deklaratave të palëve lidhur me dënimin, gjykata, të pandehurin në fjalë, e shpalli fajtor dhe në pajtim me nenin 233 paragrafi 21, i shqiptoi dënimin si në dispozitiv të aktgjykimit. Me dënimin e shqiptuar të pandehurit, gjykata, vlerëson se do të arrihet qëllimi i dënimit, ashtu që, i pandehuri në të ardhmen do të ketë më tepër kujdes në komunikacion, e gjithashtu edhe personat e tjerë të jenë më të kujdesshëm.

Për shpenzimet e procedurës gjykata ka vendosur në kuptim të nenit 453 parag.1, e në lidhje me nenin 450 paragrafi 1 nënparagrafi 2.6 të KPPK-së.

Nga të cekurat më lartë gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata Themelore Gjilan, - Departamenti i përgjithshëm

P.nr.473/16, më 06.10.2017

Sekretarja juridike
Rafete Sylaj, d.V.

Gjyqtari
Islam Thaçi, d.V.

Këshilla Juridike: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.